



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 4342/2026  
Data: 12.05.2026

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e katër -IV- për vitin 2026 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 22.04.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .
4. Informatë për ndarjen e bursave.
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson: për pikat e të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson: kërkoj që në rend të punës të hynë edhe dy pika , njëra ka të bëjë me Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026, kurse pika tjetër ka të bëjë me kërkesën për futjen e projektit të ri “Blerja e një automjetit zyrtarë” në kuadër të buxhetit për vitin fiskal 2026. Më herët nuk kam mundur me i përgatitur këta dy shkresa pasi që Ministria nuk na ka lejuar me përgatitur bartjen e bilancit të pashpenzuar për shkak se nuk ka qenë i publikuar raporti për pasqyrat financiare për 2025.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim sa i përket rendit të punës, nëse nuk ka i hedh në votim pikatë shtesë; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

## Procedojmë me këtë Rend të Punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
4. Informatë për ndarjen e bursave.
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026 i N.P.L. “Pastrimi” sh.a.
6. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026.
7. Kërkesë për futjen e projektit të ri “Blerja e një automjeti zyrtar” në kuadër të buxhetit për vitin fiskal 2026.
8. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson: buxheti i Komunës së Hanit të Elezit, i ndarë sipas Ligjit Nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, është në lartësi prej 4,234,682.00 €. Ndërsa, buxheti përfundimtar është 4,340,251.12 €, ku në këtë shumë përfshihen: mjetet e ndara nga grantet qeveritare në shumë prej 3,877,962.00 €, projeksioni i të hyrave vetanake në shumë prej 356,720.00 €, donacioni nga Unioni Evropian për projektin dyvjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 102,497.64 €, donacion nga Këshilli i Evropës në shumë prej 2,957.80 €, si dhe mjete të mbetura nga grantet, të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €. Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €, ndërsa realizimi është në shumë prej 24,021.47 €. Në krahasim me vitin 2025 kemi 13,217.65 € më pak se në vitin paraprak. Në këtë tabelë, të hyrat e realizuara për TM1 2026 dhe 2025 janë pa gjokat e trafikut, të gjykatave dhe pa ato të Agjencisë Pyjore të Kosovës. Në tabelën tjetër janë paraqitur të hyrat për secilën drejtori dhe sa ka inkasuar. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Paga dhe Shtesa” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 804,948.91 €, apo 32.13% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë periudhës raportuese të vitit 2026 është më i lartë për 244,257.01 €, apo 43.56% më shumë. Te tabela numër dy, diferenca e të hyrave direkte në shumë prej 1,856.12 € ka të bëjë me kthimin e donacionit të mbetur nga Këshilli i Evropës. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Mallra dhe Shërbime” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 52,408.04 €, apo 9.18% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2026 është më i ulët për 44,415.38 €, apo 45.87% më pak. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Shpenzime Komunale” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 9,757.67 €, apo 8.79% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2026 është më i ulët për 13,444.36 €, apo 57.94% më pak. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Subvencione dhe Transfere” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 25,089.00 €, apo 13.56% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2026 është më i lartë për 24,289.00 €, apo 3036.13% më shumë. Nga kategoria buxhetore “Shpenzime Kapitale”, përgjatë TM1 të viteve 2026 dhe 2025, nuk ka pasur shpenzim. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund të parashtroni.

**Medina Imishti** thekson: te projeksioni i të hyrave vetanake ju potencuat se shuma totale është 356,720.00 €. Ndërsa, te tabelari tjetër i raportit, konform buxhetit, te kodi njëzet e një, projeksioni i të hyrave është në shumë prej 428,222.00 €. Kërkoj sqarim. E njëjta është po te ky tabelar edhe te totali i shpenzimit 435,233.00 €. Te kategoria “Mallra dhe Shërbime”, te 14310, është një shpenzim prej 4,592.00 €, që është kompensimi i përfaqësimit brenda vendit. Kërkoj sqarim se për çfarë aktiviteti bëhet fjalë. Te kategoria “Subvencione dhe Transfere” është bërë një transfer në shumë prej 25,000.00 €. Kërkoj sqarim se ku janë transferuar këto mjete.

**Lindita Ballazhi** thekson: te projeksioni i të hyrave vetanake, te diferenca, nuk ka ndonjë gabim teknik, por shuma prej 356,720.00 € është projeksion fillestar i të hyrave vetanake, ndërsa raporti të cilin e keni parë në faqen numër nëntë ka të bëjë me faktin se, në fund të vitit 2025, kemi pranuar një donacion nga Unioni Evropian dhe ka pasur disa vonesa në regjistrimin e këtij donacioni, për të cilin ne nuk kemi qenë përgjegjës, pasi Unioni Evropian nuk na i ka dhënë objektivat se në çfarë kategorie duhet ta alokojmë atë donacion. Një shumë duhet të transferohet në Maqedoninë e Veriut, sepse me Maqedoninë e Veriut jemi partnerë në projektin e fituar nga Unioni Evropian. Kështu që ka pasur vonesa dhe nga Divizioni i të Hyrave e kanë regjistruar si të hyrë, dhe për atë arsye te fondi njëzet e një del më shumë. Kjo do të thotë se nuk ka ndonjë gabim, por ka të bëjë me alokimin e këtij donacioni. Totali i shpenzimit është e vërtetë që ka një diferencë të vogël te raporti i gjeneruar i SMFK-së, pasi që është gjeneruar më me vonesë, pas përfundimit të asaj periudhe. Te kategoria “Mallra dhe Shërbime”, kompensimi i përfaqësimeve brenda vendit ka të bëjë me drekat zyrtare dhe sqarime më të hollësishme nuk mundem me të dhënë, por mundem me ta përgatitur si material shtesë. Transferin te subvencionet e potencova edhe më herët. Ne, në këtë donacion, jemi partnerë me institucione dhe ministri nga Maqedonia e Veriut dhe, kur e kemi pranuar këtë donacion dhe pas regjistrimit, e kemi bërë transferin nga kategoria “Subvencione dhe Transfere” të shumës përkatëse.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U VOTUA RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2025 QË TË PËRCILLET KUVENDIT

### 3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson: rekomandimi i parë ka të bëjë me çështjen e vonesës në pagesën e faturave dhe shfrytëzime të tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga Thesari. Kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar, sepse shumë lëndë të cilat ekzekutohen vit për vit nga Thesari kanë të bëjnë me kontratën kolektive. Ne nuk mundemi t’i kontrollojmë ekzekutimet e të njëjtave dhe as nuk njoftohemi nga Thesari për këto. Kemi dhënë koment në Zyrën Kombëtare të Auditimit që të mos dalë si e gjetur, sepse ne nuk jemi ata të cilët i ekzekutojmë këto lëndë. Për këtë arsye është marrë vendim që për të gjitha komunat të jetë si e gjetur dhe kjo mbetet pjesërisht e pazbatuar. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me keqklasifikimin e shpenzimeve. Edhe kjo është pjesërisht e zbatuar, pasi që kemi pasur raste ku Thesari ka ekzekutuar shumë lëndë me vendime të gjykatave ose përmbarimore dhe mjetet financiare i kanë marrë aty ku ka pasur mjete, dhe normalisht ka dalë si keqklasifikim në kategorinë e shpenzimeve. Në vlerësimin e regjistrimit të pasurisë së pasqyrave vjetore financiare është e gjetur plotësisht e zbatuar, si dhe të arkëtueshmet. Edhe kjo është pjesërisht e zbatuar, pasi që ne kemi ushtruar kontrollin tonë në inkasimin

e të hyrave, kemi bërë njoftime të ndryshme për afatet e pagesave, kemi ofruar marrëveshje për pagesa me këste të obligimeve, por normalisht nuk është zbatuar plotësisht kjo e gjetur, pasi që shumë tatimpagues kanë ndryshuar vendbanimet e tyre dhe nuk kemi ndonjë adresë të saktë të tyre. Sa i përket të arkëtueshmeve që vijnë nga taksa e ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve, janë shumë biznese që nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, por nuk janë të çregjistruara si biznese, andaj borxhi i tyre mbetet si i arkëtueshëm. Çështja e mos themelimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm: nuk kemi mundur me planifikuar Njesisë e Auditimit të Brendshëm për shkak se nuk kemi pasur pozita të lira për të planifikuar staf të ri.

**Visar Hasallari** thekson: Ne e dimë që Komuna e Hanit të Elezit, për vitin 2024, kur po bëhet ky raport, e ka kaluar vitin me mbi katër milionë buxhet dhe me ligj të ri është se çdo organizatë, komunë apo institucion mbi tre milionë euro duhet me pasur së paku auditorin e brendshëm. A keni bërë përpjekje, apo që potencave që nuk janë të planifikuara pozitat për auditorë të brendshëm, ku ka mbetur si proces? A keni marrë ndonjë përgjigje prej Ministrisë për themelimin apo për hapjen e kësaj pozite?

**Lindita Ballazhi** thekson: Është një raport të cilin e kanë kryer auditorët për vitin 2024. Është raportimi i fundit, të cilin e bëjnë lidhur me ato të gjetura, pasi që tash do të kemi raportin e auditimit të ri për vitin 2025. Sa i përket njesisë së auditimit të brendshëm, në atë kohë kur është bërë auditimi nga punëtorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, në këtë mënyrë nuk kemi mundur të bëjmë asnjë planifikim, por me gjithë atë ne vazhdimisht kemi bërë kërkesa në Ministrinë e Financave që të na i aprovojnë jo vetëm për auditorë të brendshëm, por edhe pozita të tjera për të cilat me të vërtetë ka nevojë komuna, por nuk na janë përgjigjur pozitivisht për aprovim të stafit të ri. Kur kemi qenë në faza të planifikimit të buxhetit për vitin 2026, do të thotë në vitin 2025, kemi të aprovuara disa pozita të reja, por nuk ka pasur mjete të mjaftueshme buxhetore për të planifikuar edhe auditimin. Është e vërtetë që organizatat buxhetore, të cilat e kanë buxhetin mbi tre milionë euro, kanë të drejtë të kenë një auditor të brendshëm, por nuk është obligative me pasur, kështu që shërbimin e këtij divizioni e marrim prej Ministrisë së Financave, nga njësia e auditimit të brendshëm. Në vitet në vijim do të mundohemi ta themelojmë edhe këtë njësi të auditimit të brendshëm, pasi që ka një rëndësi shumë të madhe për mbarëvajtjen e punëve në komunë, për menaxhimin e kontrolleve, si financiare po ashtu edhe për punët e tjera, por një herë nuk ka qenë mundësia për me planifikuar.

**Kryesuesi** thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U VOTUA RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

### 4. Informatë për ndarjen e bursave.

**Kryesuesi** thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson: Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për Kushtet dhe Kriteret për Ndarjen e Bursave, kemi pranuar një raport për ndarjen e bursave, që drejtorja ka bërë thirrje për ndarje të bursave për vitin akademik 2025-2026. Pas përfundimit të kësaj thirrjeje është formuar komisioni për ndarjen e bursave dhe është bërë shpallja për fituesit e studentëve, të cilët kanë qenë përfitues të bursave. Si drejtori jemi bazuar në rregulloren për ndarjen e bursave dhe pesëdhjetë e një studentë përfitojnë shumën prej pesëqind euro, duke i përfshirë edhe studentët të cilët janë nga Republika e Maqedonisë Veriore. Gjithsej kanë aplikuar 68 studentë.

**Medina Imishti** thekson: Sa studentë, të cilët janë në vitin e parë, nuk janë përfshirë?

**Hisni Luri** thekson: Nuk janë përfshirë gjashtë studentë të vitit të parë.

**Visar Hasallari** thekson: Ne kemi qenë në proces kur është ndryshuar rregullorja, se e kemi udhëhequr një organizatë rinore, të cilën e kemi pasur në atë kohë, dhe duam të ju falënderojmë që keni bërë shtimin e numrit të studentëve, e në veçanti studentët e Maqedonisë Veriore, mirëpo prezent nuk është kolegu ynë asamblist, i cili ka qenë në pozitën të cilën jeni sot ju dhe kur kemi diskutuar ka potencuar se nuk kanë të drejtë studentët e Maqedonisë, por pas ardhjes së juve në pushtet e keni mbajtur premtimin dhe ne duhet të ju falënderojmë për këtë punë dhe Kuvendin Komunal që në atë kohë e kanë votuar këtë propozim. Ka qenë një rregull e komunës se kur ka ndarë subvencione, informacionet kanë qenë publike, por unë nuk kam mundur me i gjetë në uebfaqe zyrtare dhe në Facebook se kur janë bërë publike. A ka ndonjë problem teknik apo ku qëndron çështja? A keni pranuar ndonjë ankesë dhe, nëse keni pranuar, sa është numri i ankesave?

**Kryesuesi** thekson: Sa është numri i studentëve, në bazë të rregullores, që duhet të jenë përfitues të bursës?

**Hisni Luri** thekson: Për plotësim-ndryshim të rregullores unë e kam marrë iniciativën, por Kuvendi Komunal e ka miratuar, por e mira është që për çdo vit vetëm është rritur numri i bursave. Për uebfaqe ne e kemi përcjellë për publikim dhe, nëse nuk është publikuar, del pas shqyrtimit të afatit të ankesave. Saktë nuk e di, por mund të jenë dy apo tre aplikues të cilët kanë parashtruar ankesa. Gabime ndoshta mund të ketë, por e mira e asaj është se ne nuk po duam me i heq studentët, por vetëm po duam me shtuar. Rregullorja është ndryshuar dhe është hequr pjesa e numrit të caktuar të studentëve. Është rritur numri i subvencioneve në 40 000 €, që i bie diku deri në tetëdhjetë studentë dhe jemi tu funksionuar me atë rregullore, por nëse janë të ligjshme, ne i kishim mbështetur të gjithë ata, për shkak se në bazë të rregullores mundet dikush mos me qenë përfitues. E mira është që ne po e rrisim numrin më shumë se sa pesëdhjetë që ka qenë vitin e kaluar. Nuk kufizohet, por e mira e kësaj rregulloreje është se është hequr numri, por duhet që t'i plotësojnë disa kriteret.

**Kryesuesi** thekson: Sipas teje nuk ka numër të kufizuar të studentëve që përfitojnë bursë, nuk ka aty fund, që do të thotë se kush i plotëson kriteret e merr bursën.

**Hisni Luri** thekson: Katërdhjetë mijë euro janë, që tetëdhjetë studentë mundemi me i përfshirë. Nëse kemi buxhet edhe tetëdhjetë studentë mundemi me i përfshirë, po normal, nëse rregullorja të pezullon, nuk mundesh të jesh përfitues i bursës. Nëse një student i ka dymbëdhjetë vite që është në mjekësi dhe rregullorja, në bazë të saj, i bie që ai ka probleme me studime, por rregullorja potencon që, nëse përsëritet një vit, nuk mund të jetë përfitues i bursës.

**Kryesuesi** thekson: Në çka bazoheni që e përsërit vitin?

**Hisni Luri** thekson: Në bazë të rregullores që e parasheh janë semestrat, për shkak se nëse është viti i parë dhe semestri i gjashtë, do të thotë që nuk është në rregull.

**Kryesuesi** thekson: Nëse një student të njëjtin semestër e ka paguar dy herë, jemi në rregull me ty, por nëse thoni që një student me semestra është në rregull, por nuk i ka dhënë një pjesë të provimeve të vitit të dytë, nuk mundeni me u kapë këtu, sepse atë rregullore vetë shteti e ka, nuk e përjashton. Studentët e vitit të parë, të cilët kanë përfituar bursë, në çka jeni bazuar?

**Hisni Luri** thekson: Në bazë të rregullores që ka të bëjë për kuadrat deficitare, të cilët janë të nevojshëm për komunën.

**Visar Hasallari** thekson: Për mbledhje të kuvendit me na i kategorizuar sa janë prej Universitetit të Tetovës dhe të Shkupit, për shkak se kur është propozuar me u ndryshuar rregullorja më shumë jemi bazuar këtu.

**Kryesuesi** thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## **U VOTUA INFORMATA PËR NDARJEN E BURSIVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti** thekson: të hyrat nga shërbimet, pjesa me shkrim është 70 841.00 €, ndërsa në tabelar po del 72 000.00 €, por kryesuesja e aksionarëve ma shpjegoi që nuk janë përfshirë të hyrat e tjera, por kërkoj sqarim se çka përfshin shuma prej 1 200 €, sepse e njëjta është edhe te shpenzimet e kompanisë. Te totali nuk është i përfshirë fitimi para tatimit, prandaj do të ishte mirë që pjesa me shkrim të përputhet me tabelarin. Në raportin vjetor që e kemi pasur të kompanisë “Pastrimi” kanë qenë nëntëmbëdhjetë punëtorë, ndërsa në periudhën janar–mars 2026 ishin tetëmbëdhjetë dhe një mirëmbajtës i parqeve; a është shtuar si pozitë? Në raport pashë që janë pesë punëtorë teknikë, por më intereson të di se ku punojnë këta punëtorë. A ka punëtorë të tjerë të cilët nuk janë në listë të pagave?

**Sevime Bajrami** thekson: te shuma prej 72 000 €, vlera prej 1 200 € ka të bëjë me superpunën, pra të hyra tjera. Për pyetjet tjera do të njoftoj me shkrim.

**Kryesuesi** thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## **U VOTUA RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2026 I NPL PASTRIMI SHA QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **6. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026**

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson: totali i shumës që do të bartet është 580 184.23 €, por në shkresë nuk i kam bashkëngjitur kategoritë buxhetore, pasi që ende jemi në konsultime me disa drejtori, por për kuvend do ta përcjellim me të gjitha kategoritë dhe nënprogramet buxhetore se ku do të destinohen këto mjete.

**Kryesuesi** thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## **U VOTUA BARTJA E BILANCIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2025 NË VITIN 2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 7. Kërkesë për futjen e projektit të ri “Blerja e një automjeti zyrtar” në kuadër të buxhetit për vitin fiskal 2026

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson: financimi do të bëhet prej bilancit të pashpenzuar, për shkak se gjendja e automjetit ka filluar të amortizohet.

**Kryesuesi** thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U VOTUA KËRKESA PËR FUTJEN E PROJEKTIT TË RI BLERJA E NJË AUTOMJETI ZYRTAR NË KUADËR TË BUXHETIT PËR VITIN FISKAL 2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

## 8. Të ndryshme

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti** thekson: e kam pranuar një shqetësim prej aplikantëve që kanë qenë disa subvencione në bujqësi dhe më kanë njoftuar që ka qarkulluar një listë brenda komunës, por lista nuk është publikuar ende, që do të thotë se ka qenë një listë e përfituesve dhe kanë qenë disa vija. Kërkoj informacione se pse nuk është publikuar ende lista.

**Sevdi Dernjani** thekson: drejtorin nuk e kemi prezent, sepse kishte mundur të na përgjigjej saktë dhe nuk ka diçka për të fshehur. Komisionet ndoshta mund të bëjnë vija se kush mund t'i plotësojë kriteret e kush jo dhe për atë arsye kanë mundur të shënohen vijat, mirëpo drejtori do të japë përgjigje më adekuate.

**Visar Hasallari** thekson: drejtori i kulturës ka shpallur thirrje për subvencione, por shqetësim kam se pse nuk po publikohen siç janë publikuar në të kaluarën në rrjetet sociale, sepse ne e dimë që shumë pak persona janë përdorues të uebfaqes zyrtare.

**Sevdi Dernjani** thekson: nëse një listë përfundimtare nuk publikohet në uebfaqe, është absolutisht e papërgjegjshme dhe antiligjore, mirëpo në momentin që ndahen subvencionet del një listë përfundimtare dhe publikohet në uebfaqe dhe, në qoftë se mungon, e njoftojmë drejtoreshën dhe ajo listë duhet të publikohet patjetër, por duhet të jetë përfundimtare.

**Visar Hasallari** thekson: shqetësimi im është te thirrja, pra njoftimi publik nuk është siç ka qenë në të kaluarën, pra në Facebook, dhe e kanë parë qytetarët, por tash ka kaluar gati një javë dhe organizatat rinore nuk kanë mundur ta shohin. Uebfaqen e komunës shumë pak qytetarë e shfrytëzojnë dhe shpesh herë ka edhe probleme, se bie serveri, jo vetëm për komunën tonë, por për krejt administratën shtetërore. Cilat klube nuk kanë të drejtë të aplikojnë, për shkak se kam disa informacione nga klubet se nuk mundën të jenë përfitues nga njoftimi që e kanë marrë nga drejtoria.

**Kryesuesi** thekson: A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:10.

**Procesmbajtësi**  
**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

